

MERITA SAUKU BRUCI

NGA AUTORI TE KURATORI I BOTIMIT: ÇËSHTJE TË TEJSHKRIMIT DHE TË PIKËSIMIT

Një nga problemet e shumta me të cilat haset përgatitësi i botimit të një teksti të vjetër është edhe çështja e respektimit apo jo të një modeli pikësimi që i përket kohës kur është shkruar teksti. Fokusi i këtij punimi do të jetë mënyra si e ka përballuar dhe e ka zgjidhur tradita e filologëve në Shqipëri e më gjerë këtë vështirësi, si në rastet kur transkriptimi është bërë drejtpërdrejt nga teksti autograf, që përbën në vetvete edhe shkallën më të vështirë të transkriptimit, ashtu edhe nga tekste që na vijnë si shtypshkrime.

I. Në hullinë e traditës

Eqrem Çabej në transliterimin e *Mesharit*¹ është i prirë të respektojë vullnetin e autorit. Në studimin hyrës që paraprin tekstat e transliteruara ai pranon se ka ruajtur në transliterim ato shenja pikësimi, të cilat dallohen mirë që rrjedhin prej autorit më shumë se prej radhitësit. Për Çabejn vija tërthore (/) shihet se ka një kuptim, më fort si shenjë pikësimi (:.) edhe si shenjë e mbarimit të një paragrafi, pra me kuptimin e pikës. Po ashtu edhe të dy pikat e tekstit (:), të cilat, sipas zakonit të mesharëve perëndimorë të kohës, kryejnë shpesh punën e një presjeje a të një pikëpresjeje, shenja pikësimi këto që nuk dalin në tekst asnjëherë. Në transkriptim ai nuk i ka ruajtur, por i ka zëvendësuar me shenjë përkatëse të pikësimi².

¹ *Meshari* i Gjon Buzukut (1555) Botim kritik punuar nga Eqrem Çabej, pjesa e parë hyrje dhe transliterim, Tiranë, USHT, IHGJ, 1968.

² “Ruhet në transliterim vija tërthore /, sa herë që është e dallueshme mirë e që ka të gjarë të rrjedhë prej autorit e jo prej radhitësit. Kjo shenjë shihet se ka një kuptim, më fort si shenjë pikësimi (:.) edhe si shenjë e mbarimit të një paragrafi, pra me kuptimin e pikës. Shpesh shënon një pauzë, ose ndan dy fjalë (*ama / e; oratete / e becuome*). Nuk riprodhohen vijat tërthore të imtat, të cilat duket të rrjedhin prej radhitësit (*muoreh / bostne; e / iuue*). Ruhen në transliterim dhe të dy pikat e tekstit (:). Këto rrjedhin më fort prej autorit sesa prej radhitësit, dhe, sipas zakonit të mesharëve perëndimorë të kohës, kryejnë shpesh punën e një prese a të

Anila Omari pranon se në transkriptimin e tekstit të *Cuneus prophetarum*³, pikësimin origjinal e ka mbajtur parasysh sa ka qenë e mundur pa cenuar kuptimin e fjalisë; në raste të tjera e ka rregulluar sipas logjikës sintaksore dhe pjesërisht sipas pikësimit të variantit italisht, i cili ndjek logjikën e fjalisë dhe rregullat e drejtshkrimit të epokës. Ndërhyrjet e shumta në pikësim, sidomos në pjesën e parë, nuk janë pasqyruar në aparatën kritik për mungesë vendi.⁴

Bardhyl Demiraj, në përvojën e tij për transliterimin dhe transkriptimin e teksteve të vjetra të arealit kulturor-fetar të Shqipërisë së Veriut, konstaton se zbatohet rregullisht nga autorët e teksteve paketa e normës ortografike të italishtes lidhur me vendosjen e shenjave të pikësimit⁵. Pasi ka paraqitur inventarin e mjeteve grafike që përdor Kazazi

një pikëprese, shenja pikësimi që nuk dalin në tekst asnjëherë; kështu kjo shenjë ndan nga njëra-tjetra fjali o pjesë fjalish, po jo fjalë të veçuara. [...] Si shenja (/)si (:)) në transkribim nuk janë vënë më si të tilla, po në rasat ku duhet janë zëvendësuar me shenjat përkatëse të pikësimit. Teksti ka edhe pikëpyetjen, e cila jepet në transliterim e në transkribim.” Po *aty*, f. 6–62.

³Pjetër Bogdani, *Cuneus Prophetarum* (Çeta e Profetëve), botim kritik përgatitur nga Anila Omari, Tiranë, ASHSH, IGJL, 2005.

⁴“Shenjat e pikësimit të përdorura në CP janë presja (.), pikëpresja (:), dy pikat (:)) dhe pika (.). Pikëpresja dhe dy pikat përdoren rëndom për njëra-tjetrën, pikëpresja përdoret shpesh në vend të presjes, ndonjëherë edhe në vend të pikës apo pikëpyetjes, dhe fjala ndjekëse mund të fillojë edhe me kapitale. Presja përdoret jashtëzakonisht dëndur dhe pothuajse pa ndonjë kriter: përveç rasteve të logjikshme, ajo është vendosur edhe para fjalëzës *e* pa dallim nëse është lidhëz apo nyjë e përparme [...]. Ka mundësi që kjo të jetë punë e radhitësve, që duke mos njohur shqipen, kanë kujtuar se një njësi *e* mund të jetë vetëm lidhëz, para së cilës kanë vënë presje, ashtu si në tekstin italisht, sipas drejtshkrimit të kohës.

Në transkriptimin e tekstit, pikësimin origjinal e kemi mbajtur parasysh sa ka qenë e mundur pa cenuar kuptimin e fjalisë, përndryshe e kemi rregulluar sipas logjikës sintaksore dhe pjesërisht sipas pikësimit të variantit italisht, i cili ndjek logjikën e fjalisë dhe rregullat e drejtshkrimit të epokës. Ndërhyrjet e shumta në pikësim, sidomos në pjesën e parë, nuk janë pasqyruar në aparatën kritik për mungesë vendi.” Po *aty*, f. 18–19.

⁵“Sikurse në të gjitha shkrimet e vjetra të arealit kulturor-fetar të Shqipërisë së Veriut, edhe në tekstin tonë zbatohet rregullisht paketa e normës ortografike të italishtes lidhur me vendosjen e shenjave të pikësimit. Këtë e vërejmë në radhë të parë në vendosjen e presjes gjithkund ndërmjet gjymtyrësh fjalish a fjalish të bashkëlidhura në parataksë. Siç cekëm shkurt edhe më lart, shpesh dallimi midis presjes, pikëpresjes, dypikëshit dhe kllapave rumbullake nuk është gjithmonë i

te *Doktrina*⁶ e tij, kuratori Demiraj shpalos edhe përmirësimet që ka ndërmarrë në riprodhimin diplomatik të zgjeruar, ndër të tjera edhe në pikësimin e fjalisë dhe të periudhës, sipas normës së sotme ortografike.

Kjo praktikë pune e kuratorit për të zëvendësuar në transliterim shenjat e pikësimit, kryesisht në pikësimin e fjalisë dhe të periudhës, duke zbatuar rregullat e pikësimit të shqipes së sotme, pa marrë parasysh faktin nëse përdorimi i tyre në tekst është i rregullt, individual apo i gabuar, haset edhe në dy botime të tjera kritike të tij, përkatësisht *Fjalori* i Frang Bardhit⁷ dhe *Kuvendi i Arbrit*⁸. Por gjithsesi lexuesi mund të ndërmarrë vetë ballafaqimin me tekstin origjinal, përderisa çdo faqe e riprodhimit diplomatik të tekstit është vendosur përballë më gjegjësen e fotografuar në tekstin origjinal.

II. Përvojë vetjake: transkriptimet e teksteve të F. A. Santorit

Në punën paraprake për botimin kritik të një teksti të dhënë është e udhës që të njihesh edhe me përvojën dhe kriteret që kanë ndjekur kuratorë të tjerë që janë marrë me këtë autor përpara teje. Në rastin e Françisk

qartë. E njëjta vërejtje mund të bëhet lidhur me vendosjen e apostrofit, i cili në një shumësi rastesh mungon fare. [...] Shenjat e pikësimit i kemi zëvendësuar, duke zbatuar rregullat e pikësimit të shqipes së sotme, pa marrë parasysh faktin, nëse përdorimi i tyre në tekst është i rregullt, individual apo i gabuar. Shih për këtë Bardhyl Demiraj, *Gjon P. Nikollë Kazazi dhe "Doktrina" e tij*, Prishtinë, ASHAK, 2006, f. 253.

⁶“Në inventarin e mjeteve grafike që përdor autori në tekst, dallojmë së pari shenjat e pikësimit: pikën, presjen, pikëpresjen, dypikëshin, pikëpyetjen, vizën ndarëse në fund të rreshtit, kllapat. Dallimi në përdorim midis presjes, pikëpresjes dhe dypikëshit nuk është gjithmonë i qartë. Autori përdor edhe apostrofin, për të shënuar kryesisht bjerren e një zanoreje fundore të patheksuar, ose syresh të theksuara dobët [...]”. *Po aty*, f. 177

⁷ B. Demiraj, *Dictionarium latino-epiroticum (Romæ 1635) per R. D. Franciscum Blanchum*, Shkodër, Botime Françeskane, 2008, f. 56.

⁸ “Në inventarin e mjeteve grafike që përdor autori në tekst, bëjnë pjesë edhe shenjat e pikësimit: pika, presja, pikëpresja, dypikëshi, pikëpyetja, viza ndarëse në fund të rreshtit, kllapat (katrore dhe rrumbullake). Ndikimi i paketës së rregullave të pikësimit të italishtes është i dukshëm (Malaj 1998, 149vv.). Dallimi në përdorim midis presjes, pikëpresjes dhe dypikëshit nuk është gjithmonë i qartë.”

Shih për më shumë: *Concili Provintiaali o Cuvendi j Arbenit (Romæ 1706)*. Botim kritik. Teksti kritik – përgatitur dhe pajisur me shënime si edhe me konkordancat leksikore nga Bardhyl Demiraj, Shkodër, Botime Françeskane, 2012, f. 45.

Santorit nuk mund të anashkalosh punën dhe mundin e studiuesve si Solano, Gradilone, Fortino, Belluscio e të tjerë. Më poshtë po sjellim mënyrën se si dhe sa i janë qasur problemit të pikësimit, si edhe çfarë zgjidhjeje kanë propozuar ata. Theksojmë se sqarimet e kuratorëve për pikësimin kanë filluar të zënë vend gjithnjë e më vonë në paraqitjen e kritereve të botimit kritik të veprave të Santorit.

Në tri tekstet e punuara nga Francesco Solano, vetëm në njërin gjejmë një prononcim që ka të bëjë kryesisht me grafinë e tekstit⁹.

Giuseppe Gradilone pranon se pikësimi është modifikuar shumë rrallë prej tij dhe vetëm në ato raste kur ishte i dukshëm një hutim i autorit ose kur kërkohet të jepej më qartë kuptimi i tekstit¹⁰.

Italo C. Fortino kufizohet në evidentimin e ndërhyrjeve të tij kryesisht lidhur me përdorimin e shkronjës së madhe nga Santori¹¹.

Më i prerë Giovanni Belluscio kur shprehet se në optikën e respektimit maksimal të vullnetit të autorit dhe për të transmetuar karakterin edhe frymën antike që vepra mbart, në asnjë rast nuk ka ndërhyrë në pikësimin e përdorur nga Santori¹².

⁹ “La grafia del ms. È quella stabilita dal S. E adottata nel suo *Krështeu i shëjtëruor*, pp. 5–21, edito in Napoli nel 1855. In genere il sistema grafico adottato è costante ed esprime con sufficiente chiarezza i suoni delle parlate a.i.” Shih: Francesco Antonio Santori, *Alessio Ducagino* Melodramma. Edizione del testo albanese con traduzione e note a cura del prof. Francesco Solano, në *Quaderni di Zjarri*, Castrovillari, 1983, f. 53.

¹⁰ “La punteggiatura è stata da me modificata soltanto in quei casi in cui era evidente la distrazione dell’autore o quando esigenze di chiarezza lo hanno richiesto. Per le stesse esigenze di chiarezza ho aggiunto, quando mancava, il trattino per introdurre i dialoghi e i discorsi diretti.” Shih: Francesco Antonio Santori, *Panaini e Dellja* (Panaino e Delia) – *Fëmija pushtjerote* (La famiglia campestre), Editio princeps. Prolegomeni, trascrizione e aparato critico a cura di Giuseppe Gradilone. Bulzoni editore, 1979, f. 46–47.

¹¹ “Sono pure intervenuto nel testo originale per introdurre le lettere minuscole all’inizio di ogni verso, sia nella versione albanese che nella traduzione italiana, là dove, benché non richieste dalla punteggiatura, il Santori, seguendo l’uso del tempo, ha sistematicamente adottato le lettere maiuscole.” Shih: Italo Costante Fortino, *Le kalimere di Francesco Antonio Santori*, Prolegomeni, trascrizione, aparato critico e concordanza, Cosenza, Edizioni Brenner, 2004, f. 28.

¹² “Nell’ottica del massimo rispetto del testo originale e per mantenere il suo carattere e l’aura di antichità che esso emana, in nessun caso siamo intervenuti sulla punteggiatura usata dal Santori. Bisogna tenere presente che l’interpunzione rispecchia gli usi del tempo e quindi è possibile notare, per es. che i due punti sono

Në punën tonë për transkriptimin e dorëshkrimeve të romanit *Sofia e Kominiatëve*¹³, të dramës *Emira*¹⁴ dhe shumë teksteve të tjera në vargje, si fabula e rapsodi, kemi vënë re se Santori përdor gjerësisht pikën, presjen, pikëpresjen, pikëpyetjen, pikëçuditjen, shumëpikëshin, përgjithësisht me funksionet që ato kanë në ortografinë e sotme. Por ka raste kur ai përdor pikëpresjen (;) apo dy pikat (:) me funksionin e pikës (.). Kemi ndërhyrë për ta përmirësuar këtë shmangie të tij duke vendosur shenjën e duhur sipas rastit, gjë që ka sjellë edhe përdorimin e shkronjës së madhe pas shenjës së pikësimit kur është e nevojshme. Herë-herë vetë autori na ndihmon, pasi fjalia që pason fillon me shkronjë të madhe. Kemi ruajtur përdorimin e Santorit të kllapave rrumbullake dhe të vizës së gjatë, në rastet kur brenda një replike personazhi flet me vete, nën zë dhe më pas i drejtohet një personazhi tjetër. Në rastet kur Santori fut rrëfim, dialogë apo riprodhon shprehje brenda replikës, të cilat ai i rrethon mes vizash të vogla (-), kemi vendosur thonjëzat dyfishe (“”) apo të thjeshta (“), sipas rastit.

Por çfarë na sugjeron filologjia? Armando Balduino, një ndër filologët më në zë italianë, pohon se kur bëhet fjalë për pikësimin, është e qartë se, ashtu si në të gjitha fazat e përgatitjes së botimit kritik, duhet synuar për një bashkëpërkritje të saktë me vullnetin e autorit, duke respektuar edhe qëllimin stilistik, origjinalitetin ose edhe dëshirën eventuale për t’iu përshtatur ndonjë modeli¹⁵.

usati con funzione di punto fermo così come già rilevato in precedenza per il *Milosao* di De Rada (Genesi e Belluscio 2008:566), ma qui tale uso è ancora più evidente per via del fatto che normalmente i due punti sono seguiti da lettera maiuscola, mentre nelle canzoni in albanese essi appaiono a fine verso con questa medesima funzione.” Shih: Francesco Antonio Santori. *Il prigioniero politico libero e reduce per la Costituzione del 1848* Novella. A cura di Oreste Parise e Giovanni Belluscio, Cosenza, Edizioni Orizzonti Meridionali, 2014, f. 113.

¹³ Shih: F. A. Santori, *Sofia e Kominiatëve – Editio Princeps*, Studio introduttivo di Italo Costante Fortino. Prolegomeni, trascrizione e apparato critico di Merita Sauku–Bruci, Vol. I, Università degli Studi di Napoli *L’Orientale*, Dipartimento di Studi dell’Europa Orientale, Napoli, 2011, f. 90–91.

¹⁴ F. A. Santori *EMIRA*. Rrugëtimi i tekstit letrar dhe botim kritik i varianteve dorëshkrim në arbërishte përgatitur nga Merita Sauku Bruci. Vepër dërguar në shtyp.

¹⁵ “Anche nell’interpungere, ovviamente, così come in tutte le altre operazioni compiute per la costituzione di un testo critico, si deve mirare ad una esatta corrispondenza con la volontà dell’autore, rispettandone anche l’intento stilistico, l’originalità o l’eventuale desiderio di adeguamento ad un modello.” Shih: A.

Nga kjo rrjedh, – shton Baldino, që për autorët modernë, kur kemi në dorë autografin apo shtypshkrimin të cilin ai vetë e ka korrigjuar: ndërhyrjet në pikësimin origjinal (sigurisht duke i shpjeguar si të tilla) do të lejohen vetëm në rastet ekstreme kur mosndërhyrja do të rrezikonte rëndë kuptimin e tekstit; aty ku ky rrezik nuk ekziston çdo veçanti duhet të ruhet, edhe nëse rezulton eksentrike me normën që është në përdorim sot¹⁶.

III. Pikësimi i djeshëm dhe përdoruesi i sotëm

Natyrshëm vijmë në këtë pikë të diskutimit nëse do të “braktisnim” për një çast të dhënë rolin e kuratorit dhe do ta shikonim problemin nga pozitat e redaktorit apo edhe të përdoruesit të shqipes së sotme. Ajo që në fillim ishte thjesht një kureshtje u shndërrua në një nevojë për verifikim të faktit: çfarë ndodh kur ballafaqojmë vullnetin e autorit (pra edhe të kuratorit) me atë të lexuesit a përdoruesit, duke mos anashkaluar edhe vullnetin e redaktorit të një vepre? Mënyra e mirë për ta studiuar këtë problem dhe për të parë se si do të reagoje përdoruesi i sotëm do të ishte ta vendosnim atë përballë një teksti të zhveshur nga shenjat e pikësimit dhe të shihnim nëse një tekst i hartuar nga një autor i shek. XIX, që respekton paketën e shenjave të pikësimit të kohës kur u shkrua, do të sillte para nesh po ato shenja pikësimi të autorit. Provuam me një tekst të shkurtër të përzgjedhur si bazë krahasimi nga drama *EMIRA* e F. A. Santorit, hartuar dorëshkrim më 1864 dhe transkriptuar prej nesh. Iu drejtuam një grupi rastësor dhe të larmishëm përdoruesish me mosha e formime të ndryshme. Morëm në konsideratë edhe redaktorë të ndryshëm të botimeve jokritike të kësaj drame në vite. Bashkëngjitëm edhe një variant teksti të përshtatur në shqipen e sotme për një identifikim më të shpejtë të tekstit, si edhe i orientuam vetëm me përdorimin e shkronjës së madhe. Nga tekstet e përzgjedhura po japim këtu për të respektuar caqet e këtij punimi rezultatet e njërit prej tyre.

Balduino, *Manuale di filologia italiana*. Edizioni Biblioteca aperta, Sansoni, 2001, f. 216.

¹⁶ “Ne deriva che, per autori moderni, quando si disponga dell’ autografo o di edizioni dall’ autore in persona vigilate, ritocchi alla punteggiatura originaria saranno ammessi (e sempre esplicitandoli come tali) soltanto nei casi estremi in cui. Il non intervento rischierebbe di compromettere gravemente la comprensione del testo; ove quest’ultimo pericolo non sussista, ogni particolarità va invece salvaguardata anche se dovesse risultare eccentrica rispetto alle norme consuete.” *Po aty*, f. 216, shënimi 186.

Teksti i hartuar nga Santori (Emira, Akti III, skena VI, fl. 131):

Kallonjeri: Cilën magjepsī kē ti prē mua ndē gol, ndē thēna, ndē bēna, ndē tē tundura, ndē lot, e ndē gjith vethēnē tēnte? Qeshēn, e mē rrēmpenē; qanē e mē pēllqenē; vjenē, e mē hārepsēn; vete, e mē merēngonē; mē shanē e nēnk mē dhēmpēn; mē nēmēnē e nēnk mē mbēshonē; rēkonē e mē pērtrollēn fuqinē; ikēn, e mē flluturonē shpirtin; rrī, e bēn'e harronjē gjellēn!... Pafçē lipsī meje, Emirē, pafçē lipisi!

Teksti i paraqitur si testim

Subjekti: (folës, redaktor)

Mosha:

Arsimimi:

Profesioni sot: ...

Gjuha e huaj (nga e cila ndikohet në lexime):

Redaktori:

Kallonjeri: Cilën magjepsī kē ti prē mua ndē gol ndē thēna ndē bēna ndē tē tundura ndē lot e ndē gjith vethēnē tēnte Qeshēn e mē rrēmpenē qanē e mē pēllqenē vjenē e mē hārepsēn vete e mē merēngonē mē shanē e nēnk mē dhēmpēn mē nēmēnē e nēnk mē mbēshonē rēkonē e mē pērtrollēn fuqinē ikēn e mē flluturonē shpirtin rrī e bēn e harronjē gjellēn Pafçē lipsī meje Emirē pafçē lipisi

Kallonjeri: Ç magjepsje ke ti për mua në buzë në fjalë në bëma në lëvizje në lotë dhe në të gjithë veten tēnde Qesh e mē rrēmben qan e mē pēllqen vjen e mē josh vete e mē mallēngjen mē shan e nuk mē dhemb mē nēm e nuk mē rēndon rēnkon e mē dērmon fuqinē ikēn e mē fluturon shpirtin rri dhe mē bēn tē harroj jetēn Kij mēshirē për mua Emirē kij mēshirē

Më poshtë po paraqesim tipologjinë e të anketuarve me siglat përkatëse¹⁷, rezultatet e testit dhe po i lejojmë vetes të bëjmë ndonjë koment.

¹⁷ (A): I.A., 60 vjeç, arsim i lartë, arkiviste, stenografe, redaktore, ndikohet nga italishtja e frëngjishtja;

(B): B.A., 62 vjeç, arsim i lartë, aktor;

Në rastin e përdorimit të **pikëpyetjes (?)** në fund të fjalisë së parë hasëm në këtë rezultat: përgjithësisht pikëpyetja është respektuar nga 6 të anketuar dhe nga 4 redaktorët e teksteve, në 1 rast është realizuar me pikëçuditje dhe në 6 raste të tjera me pikë. As prania e fjalës pyetëse *cilën* nuk i ka orientuar këta të fundit në identifikim.

Cilën magjepsī kē ti prē mua ndē gol, ndē thēna, ndē bēna, ndē të tundura, ndē lot, e ndē gjith vethenē tēnte?

- mungesë shenje:
- pikëpyetje: 10 (E, F, G, GJ, H, M) (S, R, SH, KK)
- pikëçuditje: 1(J)

(C): A.S., 55 vjeç, arsim i mesëm, shofer, lexues i rregullt, ndikohet nga italishtja;
(D): A.S., 21 vjeç, arsim i lartë, student, ndikohet nga anglishtja;
(E): E.K., 44 vjeç, arsim i lartë, redaktore, ndikohet nga frëngjishtja;
(Ë): R.M., 39 vjeç, arsim i lartë, kërkuese shkencore, ndikohet nga italishtja;
(F): A.Ç., 42 vjeç, arsim i lartë, kërkuese shkencore, ndikohet nga anglishtja;
(G): E.SH., 65 vjeç, mësuese e gjuhës shqipe, në pension;
(GJ): A.S., 16 vjeç, arsim i mesëm, nxënëse, ndikohet nga anglishtja;
(H): A.L., 60 vjeç, arsim i lartë, shkrimtare;
(J): A.B., 35 vjeç, arsim i lartë, marrëdhënie ndërkombëtare, lexuese e mirë, ndikohet nga italishtja;
(K): E.B., 32 vjeç, arsim i lartë, administrues, lexues i rregullt, ndikohet nga anglishtja;
(L): E.S., 45 vjeç, arsim i lartë, librare, shkruan, ndikohet nga anglishtja;
(M): M.SH., 41 vjeç, arsim i lartë, juriste, ndikohet nga anglishtja.
Ndërsa kuratorët dhe redaktorët që kemi marrë në shqyrtim janë:
(S): A. Francesco Santori, *Emira*, Edizione del testo albanese con traduzione e note a cura del prof. Francesco Solano, Comune di Cerzeto/Qana, Biblioteca Comunale, Scuola tip. Italo-Orientale 'S. Nilo', Grottaferrata, 1984, 291 pp., f. 154.
(R): Frangjisk Anton Santori, Vepra 2, *Emira* (Dramë në pesë akte), Prishtinë, Rilindja, 1994. Botim me tekst përbri: ai i transkriptuar nga Françesko Solano në të majtë dhe me tekst të përshtatur në gjuhën e sotme letrare nga Ramiz Kelmendi, Redaktor Fahredin Gunga, f. 200.
(SH): Anton Santori, *Emira*, Shkup, Flaka e vëllazërimit, 1997. Redaktor Resul Shabani, f. 111.
(KK): Frangjisk Anton Santori, *Emira*, Dramë në pesë akte, Vepra (përshtatja në gjuhën e sotme letrare nga Ramiz Kelmendi, redaktoi Klara Kodra, Tiranë Argeta LMG, 2006, f. 137.

- pikë: 6 (A, C, D, Ë, K, L)
- presje:
- pikëçuditje + pikëpyetje: 1(B)
- pikëçuditje + tri pika:

Sa i takon përdorimit nga autori të **presjes** brenda fjalisë së parë për të ndarë gjymtyrët homogjene të ndërtuara pa lidhëza, zgjedhja e shenjës nga të anketuarit dhe redaktorët përputhet plotësisht me atë të autorit. Në 2 raste (K,GJ) nga të anketuarit dhe në 3 raste nga redaktorët është vendosur presja edhe kur gjymtyrët e fundit lidhen me lidhëzën *e*: (*ndë lot, e ndë gjith vethënë tënte*).

- mungesë shenje:
- pikëpyetje:
- pikëçuditje:
- pikë:
- presje: 18 (A, B, C, D, E, Ë, F, G, GJ, H, J, K, L, M) (S, R, SH, KK)
- pikëçuditje + pikëpyetje:
- pikëçuditje + tri pika:

Pikëçuditja (!) nuk respektohet përgjithësisht nga të anketuarit në rastin kur mbyll një periudhë të gjatë që përmban disa togje fjalish e që mund qëndrojnë të pavarura nga njëra-tjetra. E gjejmë përdorimin e saj vetëm në dy raste dhe të përforcuar me tri pika në rrafsh redaktorësh.

rrë, e bën'e harronjë gjellën!...

- mungesë shenje:
- pikëpyetje:
- pikëçuditje: 2 (B) (KK)
- pikë: 13 (A, C, D, Ë, E, F, G, GJ, H, J, K, L, M)
- presje:
- pikëçuditje + pikëpyetje:
- pikëçuditje + tri pika: (S, K, SH)

Më të sigurt të anketuarit janë kur fjalia thirrmore shpreh qartas një kërkesë a lutje:

Pafçë lipsi meje, Emirë, pafçë lipisi!

- mungesë shenje: 1(K)
- pikëpyetje:
- pikëçuditje: 14 (A, B, Ë, E, F, G, GJ, H, J, M) (S, R, SH, KK)
- pikë: 3 (C, D, L)
- presje:
- pikëçuditje + pikëpyetje:
- pikëçuditje + tri pika:

Në rastin e përdorimit të **pikëpresjes (;)** rezultatet janë akoma më të largëta nga pika e nisjes. Fragmenti që kemi përzgjedhur përbën një rast tipik kur pikëpresja përdoret për të ndarë fjali të bashkuara pa lidhëza, kur janë mjaft të zgjeruara; po ashtu kur kërkohet të theksohen faktet e shprehura nga ndarja e tyre¹⁸. Frazat paralele që autori ndan me pikëpresje brenda periudhës kanë dukshëm ngjyrim rrjedhimor a kundërshtor.

<i>Qeshën, e më rrëmpenë;</i>	ngj. rrjedhimor
<i>qanë e më pëllqenë;</i>	ngj. kundërshtor
<i>vjenë, e më harepsën;</i>	ngj. rrjedhimor
<i>vete, e më merëngonë;</i>	ngj. rrjedhimor
<i>më shanë e nënk më dhëmpën;</i>	ngj. kundërshtor
<i>më nëmënë e nënk më mbëshonë;</i>	ngj. kundërshtor
<i>rëkonë e më përtrollën fuqinë;</i>	ngj. rrjedhimor
<i>ikën, e më fluturonë shpirtin;</i>	ngj. rrjedhimor

Të anketuarit e kanë zëvendësuar thuajse në total me shenjën e presjes. E kanë përdorur vetëm 4 redaktorët dhe në mënyrë sporadike në një rast nga të anketuarit.

- mungesë shenje: 2 (spostim) D, E
- pikëpyetje:
- pikëçuditje:
- pikë:
- pikëpresje: 5= 1 (A – vetëm në 2/8 raste) 4 (S, R, SH, KK)
- presje: 12 (A, B, C, Ë, F, G, GJ, H, J, K, L, M)
- pikëçuditje + pikëpyetje:
- pikëçuditje + tri pika:

¹⁸ Shih: M. Ymeri dhe L. Buxheli, *Rregullat e pikësimit në gjuhën shqipe*, Tiranë, Shkenca, 2002, f. 76.

Një sërë pyetjesh na vijnë në mendje, të cilat mund të shërbejnë edhe si pikënisje për diskutime të mëtejshme:

Ky ndërkëmbim me presjen, që e kemi vënë re edhe në tekstet e tjera të përfshira në anketim, a do të kishte të njëjtin efekt stilistik, ashtu siç e parashikon parag. 117, lidhur me intensitetin e ndarjes në dallim nga pika dhe presja¹⁹?

Apo thjesht vlen rregulli që mund të ndahen me presje fjalitë e bashkuara pa lidhëza²⁰?

Apo thjesht kemi hequr dorë nga përdorimi i pikëpresjes si një shenjë e pikësimit së cilës i ka kaluar koha, pasi mund të jetë e ndërkëmbeshme me të tjera dhe kemi të bëjmë me një privilegjim të presjes? Në fakt, në rastin tonë, *Autori dhe redaktorët* konservatorë e konsiderojnë ende tërheqëse në përdorim, ndërsa përdoruesit e tjerë arkaikë, të dalë mode e të ndërkëmbeshme. A është ky një fakt i konstatuar vetëm në përdorimin e shqipes²¹?

A thua kemi ngushtim / rruhdje të sferës së përdorimit (ndoshta vetëm në administratë)?

A mund t'i mjaftonte pikëpresjes prania në ndarjen e ndërtimeve të frazave paralele, kryesisht me ngjyrim kundërshtor, për të pasur një vend në listën e shenjave të pikësimit?

Përfundime

Në këtë kumtesë janë marrë në analizë kryesisht tekste të vjetra shqipe që i janë nënshtruar një botimi kritik për të kuptuar se si e ka përballuar dhe e ka zgjidhur tradita e filologëve në Shqipëri e më gjerë këtë vështirësi, si në rastet kur transkriptimi është bërë drejtpërdrejt nga teksti autograf, që përbën në vetvete edhe shkallën më të vështirë të transkriptimit, ashtu edhe nga tekste që na vijnë si shtypshkrime. Rezulton që kuratorët të jenë kujdesur të japin shpjegimet dhe zgjidhjet e tyre për probleme që kanë hasur; zgjidhjet mund të ndryshojnë nga njëra-tjetra, por përgjegjësia për të respektuar vullnetin e autorit dhe transparencën në paraqitjen e përmirësimeve aty ku e kanë gjykuar mbetet busulla e tyre orientuese.

¹⁹ Po aty, paragrafi 117, f. 75.

²⁰ Po aty, paragrafi 113, f. 71.

²¹ Një trajtesë interesante mbi këtë problem në gjuhën frënge mund ta konsultoni në: Jacques Dürrenmatt, "Grandeur et décadence du point – virgule" në *Langue française*, 2011/4 (n° 172), f. 37–52. DOI 10.3917/lf172.0037.

BIBLIOGRAFI

- Balduino, A., *Manuale di filologia italiana*. Edizioni Biblioteca aperta, Sansoni, 2001. Bogdani, Pjetër: *Cuneus Prophetarum* (Çeta e Profetëve), botim kritik përgatitur nga Anila Omari, Tiranë, ASHSH, IGJL, 2005.
- Demiraj, B., *Gjon P. Nikollë Kazazi dhe "Doktrina" e tij*, Prishtinë, ASHAK, 2006.
- Demiraj, B., *Dictionarium latino-epioticum (Romæ 1635) per R. D. Franciscum Blanchum*, Shkodër, Botime Françeskane, 2008.
- Demiraj, B., *Concili Provintiaali o Cuvendi j Arbenit (Romæ 1706)* Botim kritik. Teksti kritik – përgatitur dhe pajisur me shënime si edhe me konkordancat leksikore nga Bardhyl Demiraj, Shkodër, Botime Françeskane, 2012.
- Çabej, E., *Meshari i Gjon Buzukut (1555)* Botim kritik punuar nga Eqrem Çabej, pjesa e parë hyrje dhe transliterim, Tiranë, USHT, IHGJ, 1968.
- Dürrenmatt, J., "Grandeur et décadence du point – virgule" në *Langue française*, 2011/4 (n° 172), f. 37–52. DOI 10.3917/lf172.0037.
- Genesin, M. – Belluscio, G., *Sistemi interpuntivi nella "scripta" albenese*. "Storia della punteggiatura in Europa", a cura di Bice Mortara Garavelli, Edizione: 2008, f. 557–570.
- Santori, F. A., *Sofia e Kominjatëve – Editio Princeps*, Studio introduttivo di Italo Costante Fortino. Prolegomeni, trascrizione e apparato critico di Merita Sauku–Bruci, Vol. I, Università degli Studi di Napoli *L'Orientale*, Dipartimento di Studi dell'Europa Orientale, Napoli, 2011.
- Santori, F. A., *Panaini e Dellja (Panaino e Delia) – Fëmija pushtjerote* (La famiglia campestre), Editio princeps. Prolegomeni, trascrizione e aparato critico a cura di Giuseppe Gradilone. Bulzoni editore, 1979.
- Santori, F. A.: Italo Costante Fortino, *Le kalimere di Francesco Antonio Santori*, Prolegomeni, trascrizione, apparato critico e concordanza, Cosenza, Edizioni Brenner, 2004.
- Santori, F. A., *Alessio Ducagino* Melodramma. Edizione del testo albanese con traduzione e note a cura del prof. Francesco Solano, në *Quaderni di Zjarri*, Castrovillari, 1983.

- Santori, F. A., *Il prigioniero politico libero e reduce per la Costituzione del 1848* Novella. A cura di Oreste Parise e Giovanni Belluscio, Cosenza, Edizioni Orizzonti Meridionali, 2014, f. 113
- Santori, F. A., *Emira*, Edizione del testo albanese con traduzione e note a cura del prof. Francesco Solano, Comune di Cerzeto/Qana, Biblioteca Comunale, Scuola tip. Italo-Orientale 'S. Nilo', Grottaferrata, 1984, 291 pp.
- Santori, F. A., *Vepra 2, Emira* (Dramë në pesë akte) Prishtinë, Rilindja, 1994. Botim me tekst përbri: ai i transkriptuar nga Françesko Solano në të majtë dhe me tekst të përshtatur në gjuhën e sotme letrare nga Ramiz Kelmendi, Redaktor Fahredin Gunga.
- Santori, A., *Emira*, Shkup, Flaka e vëllazërimit, 1997. Redaktor Resul Shabani,
- Santori, F. A., *Emira*, Dramë në pesë akte, *Vepra* (përshtatja në gjuhën e sotme letrare nga Ramiz Kelmendi, redaktoi Klara Kodra, Tiranë Argeta LMG, 2006.

